

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 4.03.2025*

**4.03.2025
Ora 16:12**

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e kërkesave të disa koalicioneve, për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025”.

PJESËMARRJA :

KQZ:


- Z. Ilirjan Celibashi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- Stafii KQZ: Znj. P. Doçaj, znj. L. Veliu, znj. L. Dulo.
Parti Politike: PD (z.F. Nuri), PL (z.K. Kolndreu), PDIU (z.Sh.Sulo)
Të tjerë: S’ka!

Z. I. Celibashi: Atëherë në rend dite të kësaj seance kemi shqyrtimin e tre kërkesave për regjistrimin e tre koalicioneve zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvend të Shqipërisë të datës 11 Maj 2025. Po Licela, secilën prej kërkesave.

Znj. L. Veliu: Koalicioni “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj”, me shkronja nistore Nisma SHB, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025 përbërë nga partitë politike :

- Partia “Lëvizja Shqipëria Bëhet”, me kryetar zotin Adriatik Lapaj, përfaqësuar nga zonja Dorina Prethi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 157 datë 24.02.2025.**
- Partia “Nisma Thurje”, me kryetar zotin Endrit Shabani, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 144 datë 24.02.2025.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 4.03.2025*

- Partia “Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”, me kryetar zotin Marjus Malaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 182, datë 25.02.2025.

Në lidhje me Koalicionin “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj”, bazuar në marrëveshjen e depozituar në KQZ, rezulton se Parti udhëheqëse e koalicionit është “Partia Lëvizja Shqipëria Bëhet”, ndërsa partitë përbërëse të koalicionit janë: Partia “Nisma Thurje” dhe Partia “Lëvizja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë”.

Z. I. Celibashi: Në lidhje me këtë kërkesë dokumentacioni është i plotë dhe e përcjellë kërkesa brenda afatit. Mirë. Dakord. Vendosim:

- Regjistrimin e Koalicionit “Nisma Shqipëria Bëhet-Adriatik Lapaj”, përfaqësuar nga zoti Adriatik Lapaj, me shkronja nistore Nisma SHB si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025. Përbërë nga subjektet zgjedhore si më poshtë:


- Partia Lëvizja Shqipëria Bëhet, me shkronjat nistore SHB;
 - Partia Nisma Thurje, me shkronjat nistore NISMA dhe,
 - Partia Lidhja për të Drejtat e Punëtorëve Shqiptarë, me shkronja nistore LDPSH.
- Partia udhëheqëse e koalicionit është Partia Lëvizja Shqipëria Bëhet.

Z. I. Celibashi: Mirë. Kalojmë te shqyrtimi i kërkesës tjetër.

Znj. L. Veliu: Koalicioni “Djathtas për Zhvillim”, me shkronja nistore DZH, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025 përbërë nga partitë politike:

- Partia “Djathtas 1912”, me organ drejtues Kolegji Politik i përbërë nga zoti Arbi Agalliu, zoti Enkelejd Alibeaj, zonja Eriselda Çelaj, zoti Agron Kapllanaj, zonja

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 4.03.2025*

Edlira Devolli, zoti Edvin Kulluri dhe zonja Eva Vako regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 206, datë 26.02.2025.

- Partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”, me bashkëkryetar zoti Dashamir Shehi dhe zoti Eqerem Spahiu, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 179, datë 25.02.2025.

Në lidhje me Koalicionin “Djathtas për Zhvillim”, bazuar në marrëveshjen e depozituar në KQZ, rezulton se Parti Udhëheqëse e Koalicionit, është Partia “Djathtas 1912”, ndërsa parti përbërëse e Koalicionit është partia “Lëvizja për Zhvillim Kombëtar”.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Edhe kjo kërkesë është në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, ndaj vendosim regjistrimin e Koalicionit “Djathtas për Zhvillim”, përfaqësuar nga zoti Dashamir Shehi, me shkronja nistore DZH, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 Maj 2025, përbërë nga subjektet zgjedhore si më poshtë:


- Partia Djathtas 1912, me shkronja nistore Djathtas 1912;
- Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, me shkronjë nistore LZHK.

Partia udhëheqëse e koalicionit është Partia Djathtas 1912.

Znj. L. Veliu: Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025 përbërë nga partitë politike :

- Partia Demokratike, me kryetar zotin Sali Berisha, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 145, datë 24.02.2025.
- Partia e Lirisë, me kryetar zotin Ilir Metaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 152, datë 24.02.2025.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 4.03.2025*

- Partia Republikane Shqiptare, me kryetar zotin Fatmir Mediu, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 186, datë 25.02.2025.
- Partia Demokristiane e Shqipërisë, me kryetar zotin Nard Ndoka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 153, datë 24.02.2025.
- Partia Bashkimit për të Drejtat e Njeriut, me kryetar zotin Vangjel Dule, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 162, datë 25.02.2025.
- Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë, me kryetar zotin Agron Duka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 169, datë 25.02.2025.
- Partia Kombëtare Konservatore Albania, me kryetar zotin Kujtim Gjuzi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 143, datë 24.02.2025.
- Partia Emigracioni Shqiptar, me kryetar zotin Kostaq Papa, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 173, datë 25.02.2025.
- Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, me kryetar zotin Gjet Ndoj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 209, datë 26.02.2025.
- Partia Aleanca Europiane Ekologjike, me kryetar zotin Sazan Guri, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 225, datë 28.02.2025.
- Partia Personat me Aftësi të Kufizuar, me kryetar zotin Gjovalin Shqalshi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 180, datë 25.02.2025.
- Partia Lëvizja Demokratike Për Ndryshim me kryetar zotin Nikolin Staka, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 175, datë 25.02.2025.
- Partia Lëvizja e Legalitetit, me kryetar zotin Shpëtim Axhani, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 155, datë 24.02.2025.
- Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, me kryetar zotin Ylber Valteri, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 149, datë 24.02.2025.
- Partia Ora e Shqipërisë, me kryetar zotin Zef Shtjefni, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 172, datë 25.02.2025.


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 4.03.2025*

- Partia Lidhja Demokristiane Shqiptare, me kryetar zotin Mhill Gecaj, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 166, datë 25.02.2025.
 - Partia Kristian Demokrate, me kryetar zotin Dhimitër Muslia, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 156, datë 24.02.2025.
 - Partia Fryma e Re Demokratike, me kryetar zotin Sali Shehu, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 178, datë 25.02.2025.
 - Partia Bashkimi Liberal Demokrat, me kryetar zotin Arian Starova, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 176, datë 25.02.2025.
 - Partia Balli Kombëtar, me kryetar zotin Adriatik Alimadhi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 150, datë 24.02.2025.
 - Partia Balli Kombëtar Demokrat, me kryetar zotin Artur Roshi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 148, datë 24.02.2025.
 - Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar, me kryetar zotin Selami Jenishehri, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin, nr. 205 datë 26.02.2025.
 - Partia për Europianizim dhe Integrimin e Shqipërisë, me kryetar zotin Rivelino Çuno, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 207, datë 26.02.2025.
 - Partia Rruga e Vërtetë Shqiptare, me kryetar zotin Muharrem Doda, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 184, datë 25.02.2025.
 - Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin Europian, me kryetar zotin Vasil Sterjovski, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 163, datë 25.02.2025.
 - Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, me kryetar zotin Shpëtim Idrizi, regjistruar si subjekt zgjedhor në KQZ me vendimin nr. 167, datë 25.02.2025.
- Në lidhje me Koalicionin “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, bazuar në marrëveshjen e depozituar në KQZ, rezulton se parti udhëheqëse e koalicionit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 4.03.2025*

është “Partia Demokratike”. Në përfundim, bazuar në shqyrtimin dhe verifikimin e kryer, dokumentacioni shoqërues i paraqitur nga subjektet politike është në përputhje me kriteret e parashikuara në nenin 65, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Bashkëlidhur projektvendimet përkatëse. Faleminderit!

Z.I.Celibashi: Faleminderit! Po, përfaqësuesi i Partisë Demokratike në lidhje me këtë kërkesë?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po faleminderit zoti Celibashi. Sikundër u relatua nga administrata e KQZ-së, dje brenda afatit ligjor Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore” ka depozituar kërkesën për regjistrimin e këtij koalicioni, në protokollin e KQZ-së, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm dhe të kërkuar nga neni 65 i Kodit Zgjedhor. Ky koalicion i drejtuar nga Partia Demokratike, përfshin 26 parti politike të drejtuara nga Partia Demokratike e Shqipërisë, me kryetarin prof.doktor Sali Berisha. Këtu kemi prezent disa nga përfaqësuesit e partive pjesë e koalicionit dhe mendoj se të gjithë jemi dakord që përderisa plotësohen kriteret ligjore të regjistrohet Koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Kemi ndonjë diskutim tjetër? Jo nuk kemi. Mirë atëherë kërkesa është në përputhje me parashikimet e ligjit, ndaj vendosim:

- Regjistrimin e “Koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Shqipërinë Madhështore”, përfaqësuar nga zoti Sali Berisha, me shkronja nistore PDASHM, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvend të datës 11 maj 2025. Ky koalicion është i përbërë nga: Partia Demokratike, Partia e Lirisë, Partia Republikane Shqiptare, Partia Demokristiane e Shqipërisë, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt. 4.03.2025*

Agrare Ambientaliste e Shqipërisë, Partia Kombëtare Konservatore Albania, Partia Emigracioni Shqiptar, Partia Aleanca Arbnore Kombëtare, Partia Aleanca Europiane Ekologjike, Partia Personave me Aftësi të Kufizuar, Partia Lëvizja Demokratike për ndryshim, Partia Lëvizja e Legalitetit, Partia Bashkimi Demokrat Shqiptar, Partia Ora e Shqipërisë, Partia Lidhja Demokristiane e Shqiptarëve, Partia Kristian Demokrate e Shqipërisë, Partia Fryma e re Demokratike, Partia Bashkimi Liberal Demokrat, Partia Balli Kombëtar, Partia Balli Kombëtar Demokrat, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë, Partia për Europeanizimin dhe Integrimin e Shqipërisë, Partia Rruga e Vërtet Shqiptare, Partia Aleanca e Maqedonasve për Integrimin European dhe Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet. Parti udhëheqëse e këtij koalicioni do të jetë Partia Demokratike e Shqipërisë. Mirë, faleminderit! Çështje të tjera nuk kemi! Seanca mbyllet!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

